

## KËRKESË PËR INFORMACION

<b>Emër Mbiemër<sup>1</sup>:</b> Z./Znj. <b>Pamela Gjinaj</b> Shoqata "Qendra Sociale në Ndhim të Njerëzve në Nevojë" Fushë-Arrëz (QSNNN)	<b>Adresa postare:</b> Rr. "Demokracia", Ish-Zdruktaria Kati II, Fushë Arrëz <b>Adresa elektronike:</b> <a href="mailto:shoqata_qsnnn@hotmail.com">shoqata_qsnnn@hotmail.com</a> ; <b>Nr. Tel:</b> +355685840462	<b>Data:</b> 14/07/2024 <b>Nënshkrimi:</b> 
--	---	--

<b>Autoriteti Publik:</b> Bashkia Fushë-Arrëz, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, Elis Miria, <a href="mailto:info@bashkiafushearrez.gov.al">info@bashkiafushearrez.gov.al</a> ; <a href="mailto:elismiria@live.com">elismiria@live.com</a>
<b>Adresa:</b> "Rruga Qender, Fushë-Arrëz"
<b>Qyteti:</b> Fushë-Arrëz

### Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Bazuar në Ligjin Nr. 8788 për Organizatat Jofitimprurëse, i ndryshuar, Ligjit Nr. 80/2021 për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse, Ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, kërkojmë informacion si më poshtë vijon:

1. Sa është numri i popullsisë në bashkinë Fushë-Arrëz sipas të dhënave të DPGJC, e ndarë sipas Njësisve Administrative, numrit të familjeve, gjinisë dhe grup-moshave 0-6 vjeç; 7-15 vjeç; 16-18 vjeç; 19-64 vjeç dhe 65+? Sa është numri i banorëve të regjistruar në gjendjen civile dhe që jetojnë fizikisht në këtë Bashki?
2. Bazuar në organizimin administrativo-territorial të Bashkisë Fushë-Arrëz, sa qendra shëndetësore/ambulanca ndodhen në total në të gjitha njësitë administrative të bashkisë të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor parësor? Sa prej tyre janë funksionale?
3. A ka parashikuar bashkia Fushë-Arrëz në buxhetin e tre viteve të fundit investime për të rindërtuar, rikonstruktuar apo riparuar këto qendra? Sa ka qenë kjo shumë mbi bazë vjetore dhe a janë realizuar investime të tilla në tre vitet e fundit me buxhetin e bashkisë?
4. A ka realizuar bashkia trajnime në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik dhe Edukimit Shëndetësor të Drejtorisë Rajonale të OSHKSH për kualifikimin dhe trajnimin e personelit shëndetësor në lidhje me dhunën në familje, funksionimin e mekanizmit të koordinuar të referimit? Nëse po, sa është numri i trajnimeve të organizuara gjatë vitit 2023 deri më sot dhe sa është numri i stafit që ka marrë pjesë në këto trajnime?

Në bazë të nenit 15, të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar ku parashikohet se: "Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe", lutemi përcjelljen e informacionit përkatës brenda këtij afati ligjor.

Për çdo komunikim tjetër për sqarimin e kërkesës së paraqitur, mund të më kontaktoni edhe në adresën e email-it: [shoqata\\_qsnnn@hotmail.com](mailto:shoqata_qsnnn@hotmail.com)

<sup>1</sup> Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuarit

**Të tjera të dhëna**

**Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: format elektronik**

**Vetëm për përdorim zyrtar**

Data e marrjes: \_\_/\_\_/2024

Numri rendor i kërkesës:

Komente: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al, portalit *pyetshtetin.al* apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit *pyetshtetin.al*
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.